



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.955/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, i përbërë nga gjyqtarët Milena Đerić kryesues, Rrustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e Kandidatit për antarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Ferizajt. Lulzim Abazi nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Ferizajt, paraqitur kundër vendimit me nr 2948-2021 i dates 03.11.2021. Të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve (KQZ), për shpalljen e rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021 për Kuvend Komunal në senacën e Panleit të mbajtur me datë 07.11.2021. mori këtë.

## V E N D I M

**Refuzohet** i pabazuar apeli Anr.955/2021 i datës 03.11.2021, nga kandidati për antar të kuvendit komunal në komunën e ferizajti Lulzim Abazi nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës- (PDK) me seli në prishtinë, dega në komunën e ferizajti. paraqitur kundër vendimit me numer 2948-2021, i dates 03.11.2021. Me të cilën ka kërkuar që të bëhet rinumërim i votave në vendvotimin me nr 2516D-01R. në fshatin Mirash komuna e Ferizaj.

## A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 03.11.2021 nga kandidati për antar të kuvendit komunal në komunën e ferizajti Lulzim Abazi nga subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në prishtinë dega në komunën e ferizajti. në të cilën pretendon se të njetit ju kanë vjedhe 7 vota, dhe kandidatit me nr 3 u janë korigju nga 00 në 06 vota kerkon të rinumrohen kutit me nr 2516D-01R.. Lulzim Abazi me numër personal 1001324370, me numër rendor të ID 7 në vendvotimin 2516D-01R në komunën e Ferizajt, fshati Mirash, dhe subjekti i tij kishte 7 vota pas numërimit të rregullt të votave nga anëtarët e komisionit zgjedhor në atë vendvotim. i njejt thekson se nga 7 vota del se ka 00 vota. Megjithatë, në të njëjtën vendvotim Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka shpallur vetëm 00 vota në ëeb faqen e saj për këtë subjekt politik. Në bazë të formularit të bashkangjitur për harmonizimin e të dhënave dhe rezultateve nga vendvotimi 2516D-01R dhe pretendimeve të anëtarit të përmendur të komisionit zgjedhor, 7 vota janë në fakt numri i votave të kandidatëve tanë në listë, ndërsa numri i votave që subjekti politik (PDK) fitoi në atë vendvotim në atë klasë është 321. Andaj parashtresuesi i apelit pretendon se ankesa e tyre bazohet në argumente ku në bazë të formularit të bashkangjitur shihet se rezultatet janë ndryshuar nga individë në atë qendër votimi dhe se për subjektin politik të tyre fillimisht është shënuar numri i saktë i votave dhe më pas është përmirësuar (ndryshuar) shifra prej 349 votash dhe janë shkruar vetëm 000 vota. Në të njëjtin formular vërehet se janë bërë korigjime të shumta të paligjshme, që si rezultat jep se numri i votave të fituara nuk përputhet me numrin total

të zgjedhësve që kanë dalë për të votuar me numrin e fletëve të pavlefshme. Apeluesi ndër të tjera thekson se pretendon se në vendvotimin e përmendur ka ndodhur një vjedhje e rëndë e votave andaj ka kërkuar nga PZAP që në vendvotimin 2516D-01R në komunën e Ferizajit, fshati Mirash, të bëhet verifikimi i materialit zgjedhor dhe bëhet rinumërimi i votave. Apelit i ka bashkangjitur një kopje të rezultateve të publikuara në ëeb faqen e KQZ-së, një kopje të formularit për harmonizimin e të dhënave dhe rezultateve dhe një kope të kartës së identifikimit të anëtarit të Komisionit Zgjedhor të tyre.

PZAP, me datë 04.11.2021, i ka dërguar kërkesë për përgjigje Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me të cilën ka kërkuar që të përgjigjet deri me datë 04.11.2021, ora 15:00.

Në përgjigjen në ankesë të datës 04.11.2021, të KQZ-së theksohet se në bazë të Rregullës Zgjedhore 06/2013, procedura e Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve nuk lejon asnjë formular të rezultateve të kalojë ( të procedohet si i rregullt) nëse nuk përputhen votat e subjekteve me votat e kandidatëve që do të thotë se nëse subjekti nuk ka vota dhe kandidatët kanë vota atëherë Formulari nuk procedohet i rregullt dhe shkon në auditim ose subjekti ka vota dhe kandidatë nuk kanë vota formulari procedohet si i rregullt dhe shkon në auditim. Ndër të tjera është theksuar se auditimi kontrollon të gjitha këto raste dhe në bazë të gjeturave përgatit raportin dhe QNR në bazë të raportit të auditimit i rekomandohet KQZ-së që vendvotimet që kanë probleme të kësaj natyre të rinumërohen. Andaj asnjë formular që nuk ka përputhje nuk mund të procedohet si i rregullt dhe i njëjti i nënshtrohet auditimit kështu që vendvotimi në fjalë është verifikuar dhe i njëjti nuk është rekomanduar nga QNR-ja.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### **Apeli është i pa bazuar**

Nga shkresat e lëndës, rezulton se apeli i parashtruar nga Lulzim Abazi nga Subjekti Politik Partia Demokratike (PDK), dega në Komunën e Ferizajit me të cilën kërkon rinumërim të votave në vendvotimin 2516D-01R është i pa bazuar.

Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, e në rastin konkret, Paneli pasi verifikoi listën e vendvotimeve të publikuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) konstatoi se në vendvotimin me nr.2516D-01R, në Komunën e Ferizajit, Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës PDK ka gjithsej 321 vota e jo 000 ashtu siç pretendon në apelin e parashtruar. Sa përket formularit që ka bashkangjitur apelit ku pretendon se është ndryshuar numri nga 7 në 0 në formular vërehet numri 7 dhe nga përgjigja e KQZ-së konfirmohet se auditimi kontrollon të gjitha këto raste dhe në bazë të gjeturave përgatit raportin dhe QNR në bazë të raportit të auditimit i rekomandohet KQZ-së që vendvotimet që kanë probleme të kësaj natyre të rinumërohen. Andaj asnjë formular që nuk ka përputhje nuk mund të

procedohet si i rregullt dhe i njëjti i nënshtrohet auditimit kështu që vendvotimi në fjalë është verifikuar dhe i njëjti nuk është rekomanduar nga QNR-ja.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli i parashtruar nga Lulzim Abazi, kandidat për asaamble komunale i subjektit politik Partia Demokratike e kosoves (PDK) nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave për kandidatin.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Anr.955/2021 më datën 07.11.2021**

**Kryesuese e Panelit**

Milena Đerić



***Këshilla Juridike:*** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi..